

Përmes këtij raporti synohet të bëhet vlerësimi i Komunës së Prishtinës, Gjakovës, Vushtrrisë, Gjilanit dhe Pejës, në sektorin e prokurimit publik.

Ky raport përfshinë periudhën kohore janar 2017 - shkurt 2018, ku fokus ka praktikën e mira, parregullsitë, shkeljet ligjore dhe zhvillimet kryesore në prokurimin publik në nivelin lokal.

Synimi i raportit është vlerësimi i komunave në masat që po ndërmarrin për përmirësimin e prokurimit publik. Po ashtu si qëllim tjetër ka inkurajimin e zyrtarëve për t'i ndarë praktikën e mira të prokurimit publik me komunat tjera.

Indikatorët dhe metodologjia e hulumtimit tonë janë bazuar në monitorimin direkt të komunave. Për të identifikuar parregullsitë dhe praktikën më të mira të komunave, D + ka përgatitur një pyetësor për zyrtarët e prokurimit, përmes të cilit synohet vlerësimi i performancës në prokurim publik.